



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA E KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM  
DHE ANTIKORRUPSION

Nr. 4391 prot., datë 14 .10.2014

Nr. 3843 prot., datë 14 .10.2014

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (referuar më poshtë si ILDKPKI), përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, z. Shkëlqim Ganaj,

dhe

Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion në Kryeministri (referuar më poshtë si "NJKBA"), përfaqësuar nga drejtori z. Ergys Hoxha,

Bazuar në parashikimet e:

- Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, i cili përcakton se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është struktura përgjegjëse që administron deklarimin e pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e sipërpërmendur;

- Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, që përcakton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave si autoritetin qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji;
- Vendimit nr. 94, datë 15.02.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të Ministrave”, që përcakton NJKBA-në si strukturën përgjegjëse për kontrollin e brendshëm dhe antikorrupsionin në institucionet dhe entet publike,

Me synim:

- Forcimin e shtetit ligjor,
- Forcimin e luftës kundër korrupsionit, krimit ekonomik, konfliktit të interesave dhe veprimeve në kundërshtim me ligjin të nëpunësve publikë, veprime që çënojnë mirëfunksionimin e administratës publike,
- Ndërgjegjësimin e institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik, konfliktit të interesave.

Bien dakord të forcojnë bashkëpunimin dhe zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve si më poshtë vijon:

## **Neni 1** **Qëllimi**

Palët do të bashkëpunojnë për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

## Neni 2 Objekti

Palët do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit në lidhje me deklarimin e pasurive dhe interesave private nga nëpunësit publikë, rastet e konfliktit të interesave dhe të sjelljeve në kundërshtim me ligjin të nëpunësve të administratës publike.

## Neni 3 Angazhimet e palëve

1. ILDKPKI-ja merr përsipër që, në përfundim të kontrolleve të deklaramëve që ndërmer vetë sipas përcaktimeve ligjore, në rast zbulimi të veprimeve të kundraligjshme të nëpunësve publikë, të cilat janë objekt i punës së NJKBA-së, t'i dërgojë NJKBA-së një informacion përmbledhës me faktet e konstatuara, në një kohë sa më të shpejtë.
2. ILDKPKI-ja merr përsipër që në përfundim të kontrolleve të deklaramëve të iniciuara mbi bazën e informacionit të marrë nga NJKBA-ja, ta informojë këtë të fundit për rezultatet e kontrollit.
3. NJKBA-ja merr përsipër të njoftojë, në një kohë sa më të shpejtë, ILDKPKI-në për rastet kur gjatë kontrolleve që kryen, konstaton veprime të nëpunësve publikë, në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", *i ndryshuar*, dhe të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*, me qëllim fillimin e verifikimit dhe kontrollit të deklarimit të pasurisë e interesave private ose ekzistencës të konfliktit të interesave.

4. NJKBA-ja merr përsipër të njoftojë ILDKPKI-në për çdo rast të prokurimeve publike dhe kontratave administrative, kur dyshohet se procedurat janë kryer në kushtet e konfliktit të interesit.
5. NJKBA-ja, merr përsipër që në përfundim të kontrolleve të kryera mbi bazën e informacionit të marrë nga ILDKPKI-ja ta informojë këtë të fundit për rezultatet e kontrollit.

#### **Neni 4**

### **Kontribute të përbashkëta**

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë forcimit të zbatimit të ligjeve respektive, kryesisht në funksion të ndërgjegjësimit të administratës publike për çështje të luftës antikorrupsion dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit.

#### **Neni 5**

### **Bashkërendimi i punës ndërmjet palëve**

1. Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret dhe në rrugë operationale të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre, në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet tyre do të realizohet sipas parashikimeve të kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë t'u përcillet një informacion i rëndësishëm dhe urgjent, komunikimi mund të bëhet në mënyrë elektronike ose verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

4. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

## **Neni 6 Amendimet**

Palët, mund të ndryshojnë këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë, të paraqitur me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.

## **Neni 7 Konfidencialiteti**

1. Gjatë zbatimit të marrëveshjes të gjitha të dhënat e shkëmbyera ndërmjet palëve do të konsiderohen konfidenciale dhe do të menaxhohen nga persona të caktuar nga palët në marrëveshje, përveç rasteve kur ato përcaktohen ndryshe me shkrim.
2. Palët bien dakord të ruajnë njëri-tjetrin të pacënuar nga ndonjë dëmtim ose humbje që rrjedh drejtpërdrejt ose tërthorazi si rezultat i ndonjë aktiviteti të njëres palë, në përmbushje të marrëveshjes.

## **Neni 8 Dispozitat e fundit**

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
2. Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

3. Kur njëra palë kërkon të ndërpresë bashkëpunimin, sipas kësaj marrëveshje, duhet të njoftojë, paraprakisht me shkrim palën tjetër 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.
4. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në ILDKPKI dhe dy të tjera në NJKBA, pranë Këshillit të Ministrave.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua në Tiranë sot, më datë 19.10.2014.

**ILDKPKI**

**Inspektor i Përgjithshëm**

**Shkëlqim GANAJ**



**NJKBA**

**Drejtori**

**Ergys HOXHA**

